



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 121/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala, kryesues, Xhevdet Abazi, dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendlodur përkufizat e Organizatës Rrjetit Hulumtues Ballkanik për Gazetari (BIRN), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Partisë së Drejtësisë (PD) dhe Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, dhe fushatës zgjedhore në ditën e votimit në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

#### VENDIM

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat e Organizatës Rrjetit Hulumtues Ballkanik për Gazetari (BIRN), me seli në Prishtinë: Anr.121/2012, Anr.122/2012, Anr.123/2012, Anr.124/2012, Anr.125/2012, Anr.126/2012 dhe Anr.127/2012.

#### Arsyetim

PZAP, më datë 30.04.2010, ka pranuar 7. (shtatë) ankesa: Anr.121/2012, Anr.122/2012, Anr.123/2012, Anr.124/2012, Anr.125/2012 dhe Anr.126/2012 nga Organizata Rrjetit Hulumtues Ballkanik për Gazetari (BIRN), me seli në Prishtinë, me te cilat pretendohet se mbështetësit e subjekteve politike të cekura në ankesat e lartcekura gjatë ditës së votimeve të mbajtura me datën 29.04.2012 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Ferizaj, përmes faqes së Facebook kanë bërë thirrje për të votuar kandidatin e subjektit të tyre politik.

- Sipas ankesës Anr.121/2012, pretendohet se përmes faqes së Facebook, Alexandra Chaner mbështetëse e subjektit politik LVV, të dielen rrëth orës 12:00, ka bërë thirrje për të votuar kandidatin për kryetar të Komunës së Ferizajt, Faton Topalli nga subjekti politik LVV, ku sipas pretenduesit të ankesës statusi i Alexandres në faqen Facebook thotë: "29 prilli është data. E

diel është dita. Ferizaj është qyteti. 23 është numri. Fatoni është njeriu. Vetëvendosje është fitorja"- Albin Kurti".

Parashtruesi i ankesës pretendon se është bërë shkelje e nenit 36 dhe e nenit 52 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP).

Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës si dëshmi kopjen e printuar të faqes së Facebook.

- Sipas ankesës Anr.122/2012, pretendohet se të dielen përmes faqes së Facebook Afrim Kasolli, deputet i Parlamentit të Kosovës nga subjekti politik LVV, ka bërë thirrje që të votohet kandidati për kryetar të Komunës së Ferizajt i subjektit politik LVV, Faton Topalli me numër 23. Sipas parashtruesit të ankesës pretendohet se është bërë shkelje e nenit 36 dhe e nenit 52 të LZP-së. Parashtruesi i ankesës, pretendon se statusi i Afrim Kasollit në faqen Facebook thotë:"Kur të dilni të votoni, mos harroni që historia është histori e shanseve, porse 29 prilli është shansi historik. 29 prilli është data. E diel është dita. Ferizaj është qyteti. 23 është numri, Fatoni është njeriu. Vetëvendosje është fitorja, ku sipas parashtruesit të ankesës pretendohet se këto janë shkruar të dielen rrëth orës 8:30.  
Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës si dëshmi kopjen e printuar të faqes së Facebook.
- Sipas ankesës Anr.123/2012, pretendohet se Meliza Haradinaj, Asambleiste e subjektit politik AAK, në Kuvendin Komunal të Prishtinës, të dielen rrëth orës 13:00, ka bërë thirrje për të votuar kandidatin për kryetar të Komunës së Ferizajt, nga subjekti politik AAK, Naim Ferati, përmes statusit të saj në Facebook, ku sipas pretenduesit të ankesës statusi i Meliza Haradinaj në faqen e Facebook thotë :"Komuna e Ferizajt ka fatin dhe përgjegjësinë për kthimin mbrapsht të së keqës. Verdiki i sotëm i qytetarëve të Ferizajt do të jetë treguesi më i mirë se sa e pakënaqur është Kosova me keqeverisjen e deritanishme. Ktheni votën tuaj në shpresë. Ndihmoni të vijnë ditët e mira për qytetin tuaj dhe Kosovën tonë. Naim Ferati është dëshmuar se është njëri nga JU. AAK 21".  
Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës si dëshmi kopjen e printuar të faqes së Facebook.
- Sipas ankesës Anr.124/2012, pretendohet se Dardan Sejdiu, anëtar i Kryesisë së subjektit politik LVV, të dielen ka bërë thirrje përmes faqes së Facebook, që të votohet për kandidatin për kryetar të Komunës së Ferizajt, nga subjekti politik LVV, Faton Topalli numer 23.  
Parashtruesi i ankesës pretendon se është bërë shkelje e nenit 36 dhe nenit 52 të LZP-së.  
Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës si dëshmi kopjen e printuar të faqes Facebook.
- Sipas ankesës Anr.125/2012, pretendohet se Buli Buli, mbështetësi i subjektit politik LDK, ka bërë thirrje të dielen rrëth orës 10:00, të paraditës, përmes faqes së Facebook, që të votohet kandidati për kryetar të Komunës së Ferizajt, nga subjekti politik LDK, Adem Salihaj numër 27.  
Parashtruesi i ankesës pretendon se është bërë shkelje e nenit 36 dhe nenit 52 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur ankesës kopjen e printuar të faqes Facebook.

- Sipas ankesës Anr.126/2012, pretendohet se subjekti politik Partia e Drejtësisë, përmes faqes zyrtare në Facebook, ka postuar fotografi, të kandidatit për kryetar të Komunës së Ferizajt, të këtij subjekti politik, Ferid Agani, ku sipas pretenduesit të ankesës, fotot janë postuar rreth orës 12:00 të natës të datës 28 prill, me të cilin veprim sipas pretenduesit të ankesës, kjo kohë ishte valide për heshtjen zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës pretendon se është bërë shkelje e nenit 36 dhe 52 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës si dëshmi kopjen e printuar të faqes së Facebook.

- Sipas ankesës Anr.127/2012, pretendohet se Blerta Deliu, deputete e subjektit politik PDK, ka bërë thirrje të shtunën në mbrëmje rreth orës 11:00 të natës, që të votohet kandidati për kryetar të Komunës së Ferizajt, nga subjekti politik PDK, Agim Aliu, përmes faqes së Facebook, ku sipas pretenduesit të ankesës kjo është bërë gjatë heshtjes zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës, pretendon se është bërë shkelje e nenit 36 dhe e nenit 52 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur ankesës kopjen e printuar të faqes Facebook.

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak te efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i në bazë të nenit 117.2 te Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP-së ka shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre dhe te provave tjera që gjenden në shkresa të lendes, duke konsideruar se nuk është e nevojshme caktimi i seancës dëgjimore ka gjetur se:

### **Ankesat janë të pabazuara.**

Pretendimet ankimore se nga ana e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Partisë së Drejtësisë (PD) dhe Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), janë bërë shkeljet e theksuara në ankesa, janë të pabazuara, nga shkaku se nuk ka prova se subjektet e lartë përmendura kanë shkelur dispozitat ligjore në të cilat pretendojnë këto anesa.

Në fakt, nga asnjë fotografi e ofruar si provë për vërtetësinë e shkeljes së pretenduar, nuk është specifikuar data dhe koha se kur ka ndodhur shkelja e pretenduar respektivisht postimi i fotografisë/komentet e postuar. As për komentet e cituara në

ankesë, nuk ka provë se janë postuar në faqen Facebook, gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore.

Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kur dhe në çfarë kohe kanë ndodhur shkeljet e pretenduara, dhe pasi që ankesave të parashtruara nuk iu janë bashkangjitur prova bindëse që të argumentohet kryerja e shkeljeve të cekura, në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesat e lart përmendura u refuzuan si të pa bazuara.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshire është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë**

Anr. 121/2012 më datën 03.05.2012.

Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala

